



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION
PRIZREN - PRIZREN

AD.nr. 9/24
Dt. 26.09.2024
Prizren

U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar pas pranimit të informatave nga [REDACTED] ndaj prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Prizren: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 të Rregullores nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

VENDIM

KONSTATOJ si të pabazuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Prizren: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore Të Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 09.09.2024, U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, përmes *e-mailit zyrtar* ka pranuar njoftimin nga [REDACTED], se më datë 23.07.2024 kjo e fundit ka mbyllur pjesërisht rastin PPN.nr. [REDACTED], sa i përket pretendimeve për përfshirjen e prokurorëve: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], në vepra penale të korrupsionit të paraqitura në propozimin për delegim të lëndës në kompetencë të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.I.nr. [REDACTED], dt. 12.03.2024, për shkak se nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Arsyeja e këtij njoftimi nga [REDACTED], është bërë për Autoritetin Kompetent për inicim të procedurës për përgjegjësi disiplinore, të vlerësohet nëse në veprimet e të paraqiturve, gjegjësisht prokurorëve të cilëve u referohet Propozimi i Prokurorisë Themelore në Prizren PP.I.nr. [REDACTED] dt. 12.03.2024, përmbushen elementet e përgjegjësive disiplinore me qëllim të inicimit të procedurës disiplinore sipas Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

Dyshimet e para për shkelje disiplinore:

Dyshimet e para kanë qenë se në çështjen penale në trajtim ndaj të pandehurit [REDACTED] në lëndën e evidentuar nën shenjën PP/I.nr. [REDACTED] për shkak të veprës penale nga neni 267 par.1 të KPRK-së, gjatë fazës hetimore është bërë ekzaminimi i dëshmisë A#22 – telefoni i markës “Samsung A52”, në pronësi të të pandehurit [REDACTED] nga ku kanë rrjedhë komunikime për dyshime në implikim edhe të prokurorëve në fjalë!

Pasi që kemi pranuar këtë shkresë të njëjtën e kemi regjistruar në regjistrin e procedurave disiplinore dhe ka marrë numrin AD.nr.9/2024, për rastin në fjalë sipas procedurave është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht [REDACTED]

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Më datë 10.09.2024, U.D. Kryeprokurori ka kërkuar deklaratë lidhur me pretendimet në fjalë nga prokurorët [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED].

Më datë 10.09.2024, për rastin në fjalë lidhur me komunikimet e prokurorëve të apostrofuar, është kërkuar nga prokurori që ka trajtuar rastin të na ofrohen provat, përkatësisht transkriptet dhe të gjitha shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me dyshimet për sjellje eventuale të pa hijshme lidhur me prokurorët e lartcekur.

Më datë 10.09.2024 U.D. Kryeprokurori ka nxjerrë Shënim Zyrtar, i cili është vendosur në shkresat e kësaj lënde disiplinore, i cili shënim është nxjerrë referuar në dispozitat e nenit 9 par.5 dhe 6 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, lidhur me obligimin e njoftimit të palës ankuese, ngase në këtë rast nuk kemi ndonjë palë ankuese dhe shkeljet e pretenduara disiplinore kanë rrjedhë nga transkriptet e lëndës penale të trajtuar nga Prokuroria Themelore në Prizren, andaj ky shënim zyrtar në mungesë të palës ankuese, ka arsyetuar obligimin për mos njoftim.

Më datë 10.09.2024, kam pranuar shkresat e lëndës në fjalë.

Më datë 11.09.2024, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurori [REDACTED].

Më datë 11.09.2024, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurorja [REDACTED].

Më datë 17.09.2024, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurori [REDACTED].

Më datë 19.09.2024, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurorja [REDACTED].

Më datë 20.09.2024, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurori [REDACTED].

Të gjeturat e rastit disiplinor për secilin prokurorë:

1. Sa i përket prokurorit [REDAKTUAR], nga transkriptet e siguruara rezulton se i pandehuri [REDAKTUAR] komunikon me personin me emrin [REDAKTUAR] lidhur me të dyshuarin [REDAKTUAR], ky i fundit dyshohet të ketë qenë palë në trajtim nga ana e prokurorit [REDAKTUAR] sa ka qenë prokuror me transferim të përkohshëm 6 (gjashtë) mujor në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Nga përgjigja e prokurorit [REDAKTUAR], vërtetohet se i njëjti fare nuk njihet me të pandehurin [REDAKTUAR] dhe asnjëherë në asnjë formë qoftë direkte apo indirekte nuk ka pasur komunikime me të. Po ashtu, prokurori nuk e njeh fare se kush mund të jetë personi me emrin [REDAKTUAR]. Sa i përket të pandehurit [REDAKTUAR], i njëjti ka zhvilluar hetime ndaj tij sa ka qenë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, në çështjen penale PP.nr. [REDAKTUAR], në drejtim të tri veprave penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1, vepra penale “manipulimi me prova” nga neni 389 par.1 dhe vepra penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së. Ndaj të njëjtit ka aplikuar masat adekuate për sigurimin e të pandehurit në procedurë dhe të njëjtën lëndë nuk ka arritur që ta përfundoj pasi që është kthyer në Prokurorinë Themelore të Prizrenit dhe nuk ka dijeni se si është trajtuar tutje nga Prokuroria e Gjakovës. Duke vlerësuar të lartcekurat, si dhe deklaratën e të pandehurit [REDAKTUAR] dhënë për [REDAKTUAR], më datë 27.06.2024, vlerësoj se në rastin konkret vërtetohet se prokurori [REDAKTUAR] nuk ka pasur asnjë komunikim të vetëm me të pandehurin [REDAKTUAR] apo me ndonjë person tjetër rreth lëndës dhe nuk është provuar që i njëjti të ketë ndërmarrë çfarëdo veprimi favorizues në çështjen që aludonte i pandehuri [REDAKTUAR]. Andaj, mund të konstatoj se i njëjti nuk ka vepruar për asnjë moment në kundërshtim me kodin etik, apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe gjithashtu, nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

2. Sa i përket prokurores [REDAKTUAR], dyshimet e para kanë qenë se në çështjen penale në trajtim ndaj të pandehurit [REDAKTUAR], në lëndën e evidentuar nën shenjën PP/I.nr. [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale nga neni 267 par.1 të KPRK-së, ku dyshohej se prokurorja ka pas dijeni për arratisjen e të pandehurit [REDAKTUAR] duke planifikuar kinse ndërprerjen e masës së paraburgimit dhe zëvendësimin e të njëjtës me një masë tjetër për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë. Prokurorja ka dhënë sqarime të detajuara lidhur me të pandehurin [REDAKTUAR] dhe të pandehurit tjerë të trajtuar në çështjen penale nën shenjën PP.I.nr. [REDAKTUAR]. Pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore dhe sigurimit të provave materiale dhe personale, më datë 25.01.2024, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] dhe pesë të pandehurve tjerë, ku në pikën IV të propozimit të aktakuzës, konform dispozitave të nenit 190 par.1 të KPP-së, qëndron edhe propozimi i prokurores për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të gjithë të pandehurve duke përfshirë edhe të pandehurin [REDAKTUAR] dhe ky fakt hedhë poshtë të gjitha pretendimet për ndërprerje të masës nga ana e prokurorisë! Vlen të theksohet se pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar gjyqtari i procedurës paraprake nga DKR sipas detyrës zyrtare (pa marrë fare

mendim nga prokuroria) i ka ndërprerë masën e paraburgimit të pandehurit [REDACTED], por në të njëjtën ditë i pandehuri dërgohet tek gjykatësja për të mitur, me qëllim të mbajtjes së seancës së paraburgimit për shkak të veprës penale “dhunimi” nga neni 227 i KPRK-së dhe nga ajo kohë deri më tani dhe deri më datë 10.10.2024 të pandehurit [REDACTED] i është vazhduar masa e paraburgimit dhe me këtë vërtetohet se pretendimet për prokuroren në fjalë nuk qëndrojnë fare! Përkundrazi, është pikërisht puna profesionale e prokurores [REDACTED] që ka zbuluar një varg veprash penale për të pandehurin [REDACTED] dhe të pandehur tjerë të cilët janë inkriminuar në veprime të kundërligjshme. Informata e pranuar në drejtim të prokurores [REDACTED], në bazë të analizës së bërë në këtë çështje disiplinore, më së paku mund të trajtohet si një trillim me qëllim denigrimi të punës së prokurores në fjalë. Andaj, nga të lartcekurat mund të konstatoj se e njëjta nuk ka vepruar për asnjë moment në kundërshtim me kodin etik, apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe gjithashtu, nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

3. Sa i përket prokurorit [REDACTED] nga transkriptet e siguruara rezulton se i pandehuri [REDACTED] komunikon me një person deri më tani me identitet të pa identifikuar me inicialet [REDACTED] lidhur me të dyshuarin [REDACTED], ky i fundit dyshohet/pretendohet të ketë qenë palë në trajtim nga ana e prokurorit [REDACTED]. Nga përgjigja e prokurorit [REDACTED], vërtetohet se i njëjti në asnjë formë nuk ka komunikuar me të pandehurin [REDACTED] dhe ka deklaruar se asnjëherë kurrfarë kontakti nuk ka pasur me këtë person. Prokurori [REDACTED], nuk ka pasur ndonjë njohuri se kush mund të jetë personi me inicialet [REDACTED]. Gjithashtu, është me rëndësi të ceket se personi me emrin [REDACTED], i cili apostrofohet nuk është trajtuar fare nga prokurori [REDACTED], gjë e cila vërtetohet edhe nga shikimi i regjistrit elektronik. Për më tepër edhe në deklaratën e të pandehurit [REDACTED] dhënë për [REDACTED], i njëjti i pyetur për këtë çështje deklaron se nuk njuh kurrfarë personi me emrin [REDACTED]! Nga të lartcekurat, vlerësoj se prokurori [REDACTED] nuk ka pasur kurrfarë involvimi real në këtë çështje të apostrofuar dhe se i njëjti nuk ka vepruar për asnjë moment në kundërshtim me kodin etik apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe gjithashtu nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

4. Sa i përket prokurores [REDACTED], nga transkriptet e siguruara rezulton se i pandehuri [REDACTED] komunikon me një person me emrin [REDACTED], lidhur me të dyshuarin [REDACTED] nga [REDACTED], ky i fundit dyshohet të ketë qenë palë në trajtim nga ana e prokurores [REDACTED]. Nga përgjigja e prokurores [REDACTED], vërtetohet se e njëjta përveç personit me emrin [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED], në të njëjtën lëndë penale nën shenjën PP.I.nr. [REDACTED] (Smil: [REDACTED]) ka qenë i pandehur edhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED], për shkak të dyshimit të arsyeshëm që secili veç e veç kishin për të kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Ndaj të pandehurit [REDACTED], më datë 21.08.2020 janë pushuar hetimet, ndërsa pikërisht ndaj të pandehurit [REDACTED], më datë 21.08.2020 prokurorja ka ngritur aktakuzë për veprën penale

nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Prokurorja [REDACTED], ka sqaruar se asnjëherë nga asnjë person nuk është kontaktuar për këtë lëndë, ka treguar se e njeh vetëm si figurë [REDACTED] ngase është në dijeni që ka punuar në restorantin "[REDACTED]" që gjendet përballë prokurorisë, mirëpo që asnjëherë kontakt me të njëjtin nuk ka pasur. Për më tepër edhe [REDACTED] në deklaratën e dhënë për [REDACTED], i njëjti i pyetur për këtë çështje, ka mohuar në tërësi të ketë pasur ndonjë kontakt lidhur me këtë çështje penale dhe ka mohuar të ketë dijeni edhe për personin e apostrofuar. Andaj, nga të lartcekurat vërtetohet se prokurorja ka ndërmarrë veprime hetimore deri në ngritje të aktakuzës konform dispozitave ligjore dhe mund të konstatoj se e njëjta nuk ka vepruar për asnjë moment në kundërshtim me kodin etik apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe gjithashtu nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

5. *Sa i përket prokurorit* [REDACTED], nga transkriptet e siguruara rezulton se i njëjti ka pasur komunikime me shkrim me [REDACTED], në datat: 24.10.2022, 19.12.2022, 31.12.2022, 09.03.2023, 12.03.2023, 17.03.2023, por që nga fillimi në komunikimet e tija nuk ka pasur asgjë inkriminuese, nga i njëjti është kërkuar të sqarohet për ndonjë lidhje afërsie me të pandehurin [REDACTED]. Prokurori [REDACTED], në përgjigjen e dhënë me shkrim, nuk ka mohuar të ketë pasur kontakte të kohë pas kohshme me [REDACTED], për të cilin ka treguar se çdo herë ka qenë [REDACTED], ai i cili i ka shkruar dhe ato kanë mund të jenë urime për ndonjë festë apo të ngjashme ngase me të njëjtin kanë lidhje familjare, duke sqaruar se babai i nënës së [REDACTED] dhe babai i prokurorit [REDACTED] janë djem axhe. Përkundër kësaj, prokurori ka deklaruar se nga pas lufta asnjëherë nuk ka qenë në shtëpinë e tij dhe gjithashtu nuk e ka frekuentuar lokalitë e tij që gjendet përballë prokurorisë. Sa i përket shkuarjes për drekë në lokalitë që gjendet te tregu (*jo afër prokurorisë*), së bashku me prokurorin [REDACTED], ka sqaruar se atë ditë kanë qëlluar në atë pjesë dhe thjeshtë kanë dashur të drekojnë mirëpo lokalitë ka qenë i mbyllur dhe kanë drekuar në një lokal tjetër, pa pasur asnjë kontakt qoftë paraprakisht apo pas drekës me [REDACTED]. Prokurori për fund ka sqaruar se asnjëherë me [REDACTED] as edhe një kafe nuk e kanë pirë së bashku. Nga deklarata e prokurorit, po ashtu edhe nga transkriptet, vërtetohet se i njëjti asnjëherë nuk ka pasur asnjë bisedë inkriminuese apo të dyshuar me [REDACTED] dhe përputhet gjithçka me deklaratimet e prokurorit lidhur me afërsinë familjare që kanë. Andaj, mund të konstatoj se i njëjti nuk ka vepruar për asnjë moment në kundërshtim me kodin etik, apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe gjithashtu nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.


Konkluzioni:

U.D. Kryeprokurori si autoritet kompetent, nga të lartcekurat, pas vlerësimit dhe elaborimit në detaje si më lartë, si dhe pas analizimit të kësaj çështjeje disiplinore, nga deklaratat e prokurorëve të lartcekur dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar dhe vendosur se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L – 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore Të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të kësaj lënde konstatohet se prokurorët e rastit i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të gjitha veprimet e prokurorëve kanë qenë profesionale dhe ligjore dhe në kuadër të fushë veprimtarisë funksionale dhe profesionale të prokurorit të shtetit, duke mos rënë ndesh për asnjë moment me kodin etik dhe sjelljen e pahijshme të prokurorit të shtetit.

...

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.

U.D. KRYEPROKURORI



T'i dorëzohet:

- [Redacted]
- Në mungesë të palës ankuese, një kopje tjetër të ruhet në arkivë.